



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:238463
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05649381

Ac.nr.2325/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.A. nga Prishtina, Lagjja “.....” pn., të cilin e përfaqëson A.K. avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës: American International Group (AIG), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson A.K., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3340/14, datë 29.01.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 19.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit Xh.A. nga Prishtina, Lagjja “.....” pn., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3340/14, i datës 29.01.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.3340/14, të datës 29.01.2020, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Xh.A, nga Prishtina, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, me të cilën ka kërkuar që të: “Detyrohet e paditura American International Group (AIG), me seli në Prishtinë, që parashtruesit të kërkesëpadisë në emër të shpagimit të dëmit material dhe jo material t’ia kompensojë dëmin të pësuar në aksidentin e datës nga automjeti “.....” me targa dhe atë: për dhimbje fizike shumë prej 2000 €, për frikë 1000 €, për humbje të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 3.000 €,

për shëmtim 1000 €, për rehabilitim fizio-terapeutik 200 €, për ushqim të përforcuar 100 €, për ndihmë dhe kujdes të huaj 100 €, për shpenzime të shërimit 200 €, në shumë të përgjithshme prej 7,600 €, të gjitha këto me kamatë prej 3,5 %, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit me kërkesë të përmbartimit të detyrueshëm”. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që: Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën e paditësit, ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën t’ia kthej të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 11.12.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të: Aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit Xh.A. nga Prishtina, II. Detyrohet e paditura American International Group (AIG), me seli në Prishtinë, që parashtruesit të kërkesëpadiës në emër të shpagimit të dëmit material dhe jomaterial t’ia kompensoj dëmin e pësuar në aksidentin e datës nga automjeti i “....” me targa dhe atë: për dhimbje fizike shumë prej 2.000, për frikë 1.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 3.000 €, për shëmtim trupor shumë prej 1.000 €, për rehabilitim klimatik shumë prej 200 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 100 €, për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 100 €, shpenzime të shërimit shumë prej 200 €, për zvogëlim të aktivitetit punues shumë prej €. Gjithsej shumë totale prej 7.600 €, të gjitha me kamatë në lartësi prej 3.5 % nga dita e paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare me kërkesë të përmbartimit të dhunshëm. Obligohet American International Group (AIG), me seli në Prishtinë, që parashtruesit të kërkesë paditësit ti kompensojë shpenzimet procedurale sipas tarifave ekzistuese.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se në rastin konkret raporti juridiko-detyrimor nga i cili rrjedhë kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit, ka ndodhur në vitin 2006 - konkretisht me aksidentin e komunikacionit të datës 03.05.2006, në mes të paditësit dhe të sigurvearit të paditurës. Duke u nisur nga koha e ndodhjes së raportit juridiko-detyrimor, gjykata gjen se ligj i aplikueshëm në këtë çështje kontestimore është Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 29/78, 39/85, 45/89, Fletorja zyrtare e RFJ nr. 31/93 e dt. 18.06 1993). Meqë e paditura në përgjigje në padi dhe në shqyrtimin kryesor është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjykata fillimisht ka shqyrtuar çështjen e parashkrimit. Pasi që kemi të bëjmë me një afat të natyrës materialo-juridike, për të cilin konform dispozitës së Nenit 360 par.2 të LMD-së gjykata e merr parasysh vetëm nëse pala thirret në atë, prandaj gjykata së pari e ka vlerësuar afatin e parashkrimit në këtë çështje juridike. Nga dispozita e lartcekur del përfundimi se parashkrimi i kërkesës fillon të rrjedhë nga

momenti kur debitori ka kuptuar për dëmin dhe për personin që e ka shkaktuar dëmin. Meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë për kompensim të dëmit të ndodhur me datë 03.05.2006, për të cilën parashihet afat i veçantë prej tre vitesh, respektivisht afat absolut prej pesë (5) vitesh, është vlerësuar se nga koha e dëmit ka kaluar afati objektiv prej pesë vitesh për kërkesën për shpërblimin e dëmit.

Më tej, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit të atakuar gjykata ka parashtruar se nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësi shpërblimin e dëmit nga i njëjti objekt i kontestit e ka kërkuar me padinë e ushtruar me datë 20.08.2007 në lëndën C.nr.1874/07. Për këtë çështje është zhvilluar procedura kontestimore në të cilën Gjykata me aktvendimin C.nr.1874/07 të datës 15.11.2011 e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit, për shkak se paditësi i ftuar në mënyrë të rregullt, nuk ka prezantuar në seancë. Sipas vlerësimit të Gjykatës, fakti se padia e paditësit është konsideruar e tërhequr dhe është hedhur poshtë propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme, nënkupton se çështja gjyqësore është zgjidhur me vendime procedurale gjyqësore.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 360 paragraf 2, 361, 376 paragraf 1 dhe 2, 388 dhe 389 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së, lidhur me nenin 143 dhe 261 të LPK-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, nga aktgjykimi i ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë me kujdes i ka hetuar të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit që kanë të bëjnë me kohën e aksidentit. kohën e inicimit të procedurës kontestimore, fillimisht sipas padisë së vitit 2007, dhe kohën e përfundimit të procedurës me aktvendimin e datës 15.11.2011, me të cilin padia është konsideruar e tërhequr. Mbi bazën e provave vendimtare, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret, propozimi i paditësit i datës 12.06.2012 për kthim në gjendje të mëparshme, nuk paraqet veprim që e ndërprente parashkrimin. Rrjedhimisht, në rastin konkret kërkesa nga padia e paraqitur në vitin 2014 për kompensimin e dëmit nga aksidenti i vitit 2006, nga gjykata është vlerësuar si kërkesë e parashkruar. Prandaj, me aktgjykimin e atakuar (është refuzuar si e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit nga gjykata e shkallës së parë, e të cilin vendim e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm edhe kolegji i kësaj gjykate, pasi aktgjykimi i përmban të gjitha kërkesat ligjore nga neni 160 të LPK, pra përmban dispozitiv dhe arsye të qarta për faktet vendimtare si dhe referencë të drejtë për ligjin material dhe me ndikim për të vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata e Apelit si të paqëndrueshme i vlerëson pretendimet ankimore të palës paditëse për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi me nenin 360 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD -1978), përcaktohet se: “ Me parashkrim pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit ”.

Me nenin 361 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nëqoftëse me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër ”.

Me nenin 376 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin ”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet “ Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi”.

Duke qenë se me padinë e datës 11.12.2014, paditësi kërkon kompensimin e dëmit nga aksidenti i datës 03.05.2006, (tetë vite pas aksidentit), e njëjta kërkesë qartazi është e parashkruar pasi kanë kaluar afatet ligjore nga neni 376 të LMD për të realizuar shpërblimin e dëmit të pohuar si në padi, ashtu siç ka vlerësuar drejtë edhe gjykata e shkallës së parë duke vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar, si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e parashtruara e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2325/20, me datë 19.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli